

Data _____

PROCES-VERBAL
Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Instalimi i Sistemit të matjes inteligjente në konsumatorët fundor, në sistemin e matjes të Bilancit të Energjisë në kabinat elektrike TM-TU, dhe integrimi i tyre në platformën e matjes të OSSH sh.a.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Matës i ngarkesave elektrike – 38426000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

432,374,707 (Katerqind e tridhjetë e dy milion e treqind e shtatedhjetë e kater mijë e shtateqind e shtate) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Durres, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 216,187,350 (Dyqind e gjashtembedhjete milion e njeqind e tetedhjete e shtate mije e treqind e pesedhjete) leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera 216,187,350 (Dyqind e gjashtembedhjete milion e njeqind e tetedhjete e shtate mije e treqind e pesedhjete) leke është 50 % e fondit limit të përcaktuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Objekti i kësaj kontrate konsiston në objektin *“Instalimi i Sistemit të matjes inteligjente në konsumatorët fundor, në sistemin e matjes të Bilancit të Energjisë në kabinat elektrike TM-TU, dhe integrimi i tyre në platformën e matjes të OSSH sh.a”*. Referuar parashikimeve të Master planit për Planet e Investimit dhe Zhvillimit të rrjetit të shpërndarjeve, bazuar në parashikimin e ngarkesës për vitet 2024, 2029 dhe 2034, në të cilin janë parashikuar skenare të ndryshme të zhvillimit të rrjetit, për kërkesën e ngarkesës të lartë, të mesme dhe të ulët, i vihet theksi zhvillimit të rrjetit smart si në reduktimin e humbjeve, dhe ndihmes që do ofroje ky rrjet në bilancin e thjeshtuar të energjisë, ashtu edhe në zhvillimin e automatizuar të leximit të sistemeve të matjes, si dhe në Infrastruktura të avancuar të matjes, në dy kahe, në komunikimit në kohë reale të të dhënave. Duke marrë në konsideratë për sa më sipër, ku theksohet rëndësia e këtij investimi, gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e parashikuar të kontratës, afatet e të cilës shtihen në kohë, në mënyrë që autoritetit/entit kontraktor të njohë gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, për një konkurrencë sa më të fortë dhe gjithëpërfshirëse, është përcaktuar dhe vlera e mësipërme.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe parashikimet e legjislativës të fushës, aktualisht nenin 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i

ndryshuar, ku percaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministririt te Financave ne zbatim te ketij Ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter i shërben autoritetit/entitetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *nenit 29, te Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministririt te Financave ne zbatim te ketij Ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 25 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 100 %, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje përvojash, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të objektit të procedurës të prokurimit, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontratë të ngjashme, të jetë nën 50 % e vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose nën 200 %, e vlerës së fondit total, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të ndërlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. N.P – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. **Klasifikimi – E**
- b. N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. **Klasifikimi – A**
- c. N.S – 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. **Klasifikimi – A**

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimi Nr.42, datë 16.1.2008 ”PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 11	Ndërtime për N/ST, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Punime Demontim-Montim, F.V (Instalim) Panel Matje TU me TRI per vendosje brenda dhe jashte murit. Demontim – montim mates i energjise elektrike	E	342,358,707
N.S - 13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	Vënia në punë dhe pranimi operativ i paneleve të matësit të jashtëm dhe të brendshëm, matësve inteligjentë, njësive të komunikimit, HES	A	80,016,000
N.S – 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Paketa e Trajnimit për Operimin dhe Mirëmbajtjen e Njësive të Komunikimit, HES	A	10,000,000

Argumentim Teknik: Në vazhdimësi të strategjise së zhvillimit të sistemit të matjes në realizimin e zëvendësimit të sistemit (analog) të matjes së vjetër me sistem matje inteligjente, referuar detyrimeve që dalin nga Ligji për Energjinë Elektrike, nga direktivat e Komitetit European të Energjisë, OSSH sh.a. do të vazhdojë instalimin e matjes inteligjente në sistemet e matjes së bilancit të kabinave TM-TU, dhe në konsumatorët fundorë.

Instalimi i matësave inteligjent parashikon kërkesat teknike për “Furnizim, Vendosje dhe Instalim të Sistemit të matjes inteligjentë në konsumatorët fundor, në sistemin e matjes të Bilancit të Energjisë në kabinat elektrike TM-TU, dhe integrimi i tyre në platformën e matjes të OSSH sh.a.

Në investimet e përmendura më sipër, sistemi i Matësave inteligjent të instaluar është aplikuar sistemi i komunikimit nëpërmjet PLC (power line communication) me Koncentratorin e të Dhënave. Koncentratori i të Dhënave përdor karta SIM, M2M që përdorin teknologjinë GPRS ose ekuivalente.

Për vendosjen në efikasitet të plotë të investimit të realizuar me sistem matje inteligjente me komunikim nëpërmjet PLC (power line communication) me Koncentratorin e të Dhënave me matje inteligjente të bilancit me komunikim nëpërmjet PLC (power line communication) me Koncentratorin e të Dhënave, për vendosjen në punë me shfrytëzim të plotë të investimeve të lartpërmendura, në investimin në vazhdim do të përdoret e njëjta teknologji komunikimi.

Per sa mesiper, perfshihen te gjitha proceset e percaktuara ne pikat e Licensave te kerkuara.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Te pakten 1 (Nje) Inxhinier Elektrik

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 2 (Dy) Inxhiniera Elektrike
- b. 1 (Nje) Inxhinier Elektronik ose Informatik ose ekuivalent

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë te pakten 14 **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga organe kopetente te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar, si më poshtë:

- a. Te pakten 2 (Dy) Elektricista me kartela personale te sigurimit teknik Kategoria IV
- b. Te pakten 5 (Pese) Elektricista me kartela personale te sigurimit teknik Kategoria III
- c. Te pakten 7 (Gjashte) Elektricista me kartela personale te sigurimit teknik Kategoria II

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Stafi sipas pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, CV / Çertifikate perkatëse si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave.

Për të përmbushur këto kritere (2.3.3, 2.3.4, 2.3.5), operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Lidhur me kërkesat që përfshihen ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Duke u bazuar ne preventivin e ketij investimi, jane parashikuar te montohen sisteme te matjes te bilancit me TRI 15 cope, matesa 1 dhe 3 fazore ne bokse kolektive 5750 cope, matesa 1 dhe 3 fazore ne bokset individual 7972 cope, matesa ne panelet e matjes me TRI 121 cope, matesa te bilancit ne bokset kolektive 192 cope, per nje afat kohor prej 18 muajsh. Per sa mesiper rezulton se ne nje dite duhet te instalohen perafersisht 20 njesi matjeje.

Duke patur parasysh qe nje ekip pune i perbere nga 2 teknike elektrike mund te instaloje ne dite 6 matesa ne bokset individual ose 10 ne bokset kolektiv ose 2 ne panel matje me TRI, 4 matesa ne bilancin e bokset kolektiv ose 1 sistem matje te bilancit te kabinave TM – TU, perfshire gjithë punimet e tjera te demontim – montimit, dalim ne konkluzion se numri minimal i teknikeve elektrike duhet te jete 14. Gjithashtu ne keta analize duke lloogarithur ditet e festave dhe pushimet zyrtare te punonjesve, per c do rajon duhet nje Inxhinier qe ti drejtoje dhe programoje proceset.

Duke gene se fusha e veprimit te punimeve te investimit eshte e shperndare ne dy rajone, Rajoni Durres dhe Rrajoni Tirane, duhen minimumi 2 (Dy) Inxhiniera Elektrike per te bashkevepruar me grupet perkatëse te rajoneve.

Duke gene se natesat e instaluar duhet te integrohen ne platformen e komunikimit te te dhenave, te komisionohen, etj, duhet qe OE/BOE pjesemares te kete nje ekip pune per kete qellim, per kete arsye duhet minimalisht 1 (Nje) Inxhinier Elektronik ose Informatik ose ekuivalent.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), **ISO 27001:2022** ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme), **ISO 50000-1** ose ekuivalente për standartin e menaxhimit të energjisë (të vlefshme) dhe **ISO 45001** ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM - 285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 27001:2022 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm.

Kërkesa Lidhur me Certifikimin ISO 50000-1 ose ekuivalente shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të menaxhojë standartin e menaxhimit të energjisë

Kërkesa Lidhur me Certifikimin ISO 45001 ose ekuivalente ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ky standart është i nevojshëm pasi vetë karakteristikat e punës, ku punohet në tension për demontim dhe montim pajisjesh elektrike/elektroni por dhe për stafin e nevojshëm për këtë proces OE/BO pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e menaxhon në mënyrë të sigurtë sigurinë në punë.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Për materialet e listuara mëposhtë, OE/BOE Ofertues duhet të paraqesë:

- a) *Koncentrator i të dhënave (DCU).*
- b) *Mates Energjie SMART 230 V 5(100) A*
- c) *Mates Energjie SMART 3x230/400 V 5(100) A*
- d) *Mates Energjie SMART 3x230/400 V 5(6) A*
- e) *Kabllo TU*

I. Autorizim të prodhuesit / Distributorit të autorizuar për mallrat e mësipërme.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit / Distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Distributor duhet të provojë lidhjen me prodhuesin.

Shenim: *Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*

II. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Fragmentet e Katalogut në gjuhën shqip.

Shenim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

III. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deshmi të testimëve zyrtarë të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

IV. Ne menyre qe te krahasohet dhe te vleresohet pajtueshmeria me specifikimet teknike te kerkuara, OE/BO pjesemares duhet te paraqese tabelen e skedes teknike, e cila duhet te jete e plotesuar, firmosur dhe vulosur nga OE.

Kerkesat e mesiperme hartohen duke mbajtur ne konsiderate piken 8 te nenit 39 te VKM 285, ku Autoriteti/enti kontraktor, perveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, konkretisht:

Autorizimi i Prodhuesit eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervecse tregon origjinin e mallrave qe kerkohen ne procedure, na garanton se ofertusi eshte i autorizuar per ofrim tek AK te ketyre mallrave.

Katalogu/fragmentet e katalogut te prodhuesit jep nje informacion te qarte ne lidhje me mallrat qe do te ofrohen. Ky informacion perfshin te dhena te detajuara rreth materialeve dhe karakteristikeve te mallrave.

Kerkesa per paraqitjen e testimeve zyrtare, siguron nje burim te besueshem informacioni per cilesine e mallrave te kerkuar. Testet zyrtare na ndihmojne te identifikojme paraprakisht perpresite dhe mangesite e cdo materiali te ofertes.

2.4.2. Autoriteti/enti kontraktor kërko qe operatorët ekonomikë, ne ditën e hapjes se ofertave të dorëzojnë mostra të mallit (nga 1 cope), ***”Mates Energjie Smart 3x230/400 V 5(6)A”*** ***”Koncentrator te dhenash 3x230/400 V”***, ***”Mates Energjie Smart 230 V 5(100)A”***, ***”Mates Energjie Smart 3x230/400 V 5(100)A”*** pasi e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin piken 6/a te nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Paraqitja e mostrave lejon AK te beje nje krahasim te drejtperdrejte midis tyre dhe te identifikojne ate qe ofron me te miren per nevojat e tyre. Ky kriter siguron qe operatoret jane te pergatitur per te permbushur kerkesat e specifikimeve teknike dhe standarteve te kerkuara. Paraqitja e mostrave eshte nje detyrim qe i shton operatoreve ekonomike pergjegjesine per cilesine dhe pajtueshmerine

e produkteve te tyre me standartet e nevojshme. Kjo ndihmon ne sigurimin e nje malli te pershtatshem dhe te cilesise te larte.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.